LIGJ
Nr. 162/2013

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR KRYERJEN E SHËRBIMIT TË AUDITIMIT TË BORXHIT TË MINISTRIVE KUNDREJT BIZNESIT VENDAS DHE TË HUAJ

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, 83, pika 2, dhe 84, pika 4 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Objekti i këtij ligji është nxjerrja e rezultatit aktual dhe real të borxhit të akumuluar në vite, që ministritë kanë ndaj biznesit dhe sipërmarrjes së lirë për punët e kryera, shërbimet e mallrat e blera, si dhe përpunimi i politikave të menaxhimit për shlyerjen e këtij borxhi, nëpërmjet kryerjes së procedurave të një auditimi të thelluar dhe gjithëpërfshirës.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është dhënia e autorizimit për auditimin e të dhënave të zotëruara nga administrata shtetërore dhe miratimi i marrëveshjes së asistencës me audituesin e autorizuar, nëpërmjet së cilës do të rregullohen marrëdhëniet për kryerjen e shërbimit të auditimit, në përputhje me objektin e këtij ligji.

Neni 3
Fusha e zbatimit

Subjekte të këtij ligji janë:

a) të gjitha institucionet shtetërore qendrore, që zotërojnë të dhëna apo që mund të përdorin të dhënat e lidhura me borxhin, llogaritja e të cilit është objekt i këtij ligji;

b) audituesi i autorizuar që do të ofrojë shërbimin e auditimit në zbatim të qëllimit të këtij ligji.

KREU II

Neni 4
Përgjegjësia për ndjekjen e zbatimit të marrëveshjes

Ministria e Financave është institucioni qendror, i cili, në bazë të këtij ligji, ngarkohet të ndjekë zbatimin e marrëveshjes, të negociojë dhe të nënshkruajë dokumentacionin e parashikuar, sipas marrëveshjes bashkëlidhur.

Neni 5
Baza e të dhënave të audituesshme

Për qëllime të realizimit të objektit të këtij ligji, të shqyrtohen të gjitha të dhënat e zotëruara nga autoritetet shtetërore, sipas parashikimit të nenit 3 të këtij ligji, deri në datën 31.8.2013.

Neni 6
Miratimi i raportit përfundimtar

Ministri i Financave autorizohet të nënshkruajë raportin përfundimtar të auditimit me audituesin e autorizuar, sipas afateve dhe procedurave të parashikuara në marrëveshje.

Neni 7
Lidhja e marrëveshjes dhe miratimi i saj

Marrëveshja e negociuar nga grupi negociator, i caktuar me vendimin nr. 850, datë 30.9.2013, të Këshillit të Ministrave, bashkëlidhur këtij ligji, mbështetet dhe zbaton Standardin Ndërkombëtar mbi Shërbimet e Lidhura SNSHL 4400, "Angazhime për kryerjen e procedurave", në lidhje me informacionin financiar.

Neni 8
Pagesa për ofrimin e shërbimit

Pagesa për ofrimin e shërbimit, objekt i këtij ligji, përballohet nga Buxheti i Shtetit dhe nuk mund të tejkalojë shumën e parashikuar në marrëveshjen bashkëlidhur. Ky fond sigurohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë, shpallet publikisht dhe botohet në numrin më të parë të Fletores Zyrtare.

Miratuar në datën 17.10.2013

Hyrja në fuqi menjëherë është miratuar me dekretin nr. 8351, datë 17.10.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

Shpallur me dekretin nr. 8352, datë 18.10.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE
PËR KRYERJEN E SHËRBIMIT TË AUDITIMIT TË BORXHIT TË MINISTRIVE KUNDREJT BIZNESIT VENDAS DHE TË HUAJ

Neni 1
Pjesët përbërëse të marrëveshjes

Pjesët përbërëse të marrëveshjes, të cilave do t'u referohen palët gjatë ekzekutimit të saj, janë si më poshtë:

1. Shtojca A: Procedura që do të kryhen nga Deloitte;
2. Kushtet e përgjithshme të marrëveshjes;
3. Pranime dhe marrëveshje.

Neni 2
Objekti i marrëveshjes

2.1 Objekti i kësaj marrëveshjeje është plotësimi i detyrimeve të parashikuara në nenin 1 të ligjit, të cilit i bashkëlidhet kjo marrëveshje nëpërmjet kryerjes së procedurave për të asistuar Ministrinë e Financave, si institucioni shtetëror i ngarkuar me ndjekjen e zbatimit të marrëveshjes, për sa i takon përcaktimit të madhësisë së borxhit ndaj biznesit dhe sipërmarrjes, deri në datën 31.8.2013, për punë të kryera, shërbime e mallra të blera.

2.2 Për efekt të zbatimit të kësaj marrëveshjeje, me termin "auditim" të ligjit do të kuptojmë: procedurat e rëna dakord paraprakisht midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit, sipas shtojcës A të kësaj marrëveshjeje.

2.3 Procedurat e rëna dakord paraprakisht ndërmerren në përputhje me Standardin Ndërkombëtar mbi Shërbimet e Lidhura (SNSHL 4400), angazhime për kryerjen e procedurave të rëna dakord paraprakisht, në lidhje me informacionin financiar, subjekt i termave dhe kushteve të detajuara përgjatë marrëveshjes. Procedurat specifike, të cilat Deloitte do të ndërmarrë, janë detajuar në shtojcën A. Këto procedura përcaktohen dhe zbatohen në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe vlerësimi në lidhje me mjaftueshmërinë e tyre është përgjegjësi e Ministrisë së Financave, siç parashikohet dhe nga SNSHL 4400.

Neni 3
Fillimi i zbatimit të marrëveshjes

Zbatimi i marrëveshjes fillon menjëherë me nënshkrimin nga palët, por jo më vonë se 5 ditë nga hyrja në fuqi e ligjit, të cilit i bashkëlidhet kjo marrëveshje.

Neni 4
Afati i realizimit të marrëveshjes

4.1 Afati përfundimtar i realizimit të kësaj marrëveshjeje: data 30 nëntor 2013. Kjo datë është afati maksimal i dorëzimit të raportit përfundimtar të gjetjeve në gjuhën angleze.

4.2 Skeduli i realizimit të marrëveshjes do të miratohet në një akt të përbashkët midis Ministrit të Financave dhe Kontraktorit.

4.3 Rrethanat që ndikojnë në afatet dhe kostot e realizimit të marrëveshjes.

Afatet e paraqitura për realizimin e marrëveshjes janë të bazuara në një parashikim të besueshëm. Gjatë realizimit të marrëveshjes mund të lindin situata që mund të ndikojnë në mënyrë të rëndësishme afatin e përcaktuar, si dhe tarifat e përcaktuara. Këto rrethana përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në këto situata:

- Informacionet e kërkuara nuk janë: a) të siguruara nga Ministria e Financave në datën e kërkuar; b) plotësuar në një format të pranueshëm nga Deloitte; c) aritmetikisht korrekte; ose d) në përputhje me dokumentet përkatëse mbështetëse.
- Të dhënat elektronike nuk janë një format i përshtatshëm, nuk përmbajnë informacionin e kërkuar dhe nuk janë siguruar nga Ministria e Financave në datën e kërkuar për përdorimin në kryerjen e hulumtimeve të të dhënave dhe procedurave.

- Ndryshime të rëndësishme që ndodhin para lëshimit të raportit tonë dhe që kanë efekt mbi zhvillimin e procedurave.

- Ndryshime të rëndësishme në stafin e Ministrisë së Financave të caktuar për koordinimin e punës, përgjegjësitë e tyre apo gatishmëria e tyre.

- Humbje të të dhënave apo të një pjese të të dhënave të nevojshme për kryerjen e procedurave.

- Ndryshimi në qëllimin e procedurave për të cilat është rënë dakord paraprakisht, shkaktuar kjo nga ngjarje përtej kontrollit të palëve.

- Vonesa të shkaktuara nga palë të treta në kuadër të kryerjes së procedurave, si p.sh: vonesa në kthimin e përgjigjeve të letrave të konfirmimit, mosdhënie akses në të dhëna financiare apo të tjera të gjykuara të nevojshme për auditorët për kryerjen e procedurave, vonesa në sqarimin e diferencave të identifikuara etj.

Zbatimi i detyrimit për dorëzimin e të dhënave monitorohet nga Ministria e Financave. Në rast se nuk sigurohet ose nuk përgatitet informacion në afatet, saktësinë, plotësinë dhe formatin e kërkuara, atëherë Deloitte ka të drejtën që të pezullojë punën përkohësisht, derisa informacioni të merret. Deloitte ka të drejtën të rimbursohet për çdo shpenzim të shkaktuar nga një situatë e tillë, duke përfshirë këtu dhe kohën shtesë të harxhuar.

Neni 5

Vlera e shërbimit

5.1 Vlera e shërbimit objekt i kësaj marrëveshjeje është në shumën 85,000 (tetëdhjetë e pesë mijë) euro me TVSH. Kjo tarifë përfshin dhe shpenzime të tjera të nevojshme për përmbushjen e kësaj marrëveshjeje, por jo më shumë se në masën e 5% të vlerës totale të shërbimit. Nëse si pasojë e kërkesave të Ministrisë së Financave, me cilësinë e ndjekësit të zbatimit të marrëveshjes, apo të vetë projektit nevojiten shpenzime mbi këtë masë, atëherë palët do të bihen dakord nëse mund të procedohet me ato aktivitete dhe Autoriteti Kontraktor do të bëjë rimbursimin e atyre shpenzimeve. Negocimi dhe nënshkrimi i akteve për këtë qëllim bëhet nga Ministri i Financave, si institucioni i ngarkuar me ligj për ndjekjen e zbatimit të marrëveshjes.

5.2 Në varësi të rrethanave të veçanta, të listuara në nenin 4.3 që mund të ndodhin përgjatë periudhës së marrëveshjes, tarifa e parashikuar mund të ndikohet në mënyrë të ndjeshme e mund të jenë të nevojshme edhe pagesa shtesë. Deloitte do të njoftojë menjëherë Ministrinë e Financave nëse has në ndonjë rrethanë që mund të ndikojë në mënyrë të ndjeshme koston e shërbimit dhe tarifën dhe do të diskutojë me Ministrinë e Financave çdo tarifë shtesë që do të jetë e nevojshme.

Neni 6

Vendndodhja e kryerjes së shërbimit

Kryerja e shërbimit, objekt i kësaj marrëveshjeje, do të bëhet në ambientet e Ministrisë së Financave dhe në ambientet e Kontraktuesit.

Neni 7

Përgjegjësia dhe detyrimet

7.1 Ministria e Financave ka përgjegjësinë të zbatojë me përpikëri kërkesat e Deloitte për informacion e dokumentacion. Në këtë kuadër, Ministria e Financave duhet të japë informacionin e kërkuar brenda afatit të përcaktuar nga Deloitte dhe në formën e përcaktuar.

7.2 Ministria e Financave ka përgjegjësinë të sigurohet që çdo informacion që i jepet Deloitte të jetë i saktë e pa gabime.

7.3 Ministria e Financave ka përgjegjësinë të koordinojë komunikimin e Deloitte me institucione të tjera të shtetit shqiptar, si dhe të sigurohet që kompanitë, të cilat marrin letërkërkesa për konfirmim të obligimeve, t’i kthejnë përgjigjet në kohën dhe formatin e kërkuar.

7.4 Deloitte mund t'i kërkojë Ministrisë së Financave një letër përfaqësimi në të cilën të pranohen përgjegjësitë e Ministrisë së Financave për përgatitjen e informacioneve financiare. Për shkak të rëndësisë së përfaqësimeve, Ministria e Financave bie dakord të shkarkojë dhe të zhdëmtojë Deloitte, nënkontraktorët e saj dhe personelin përkatës të tyre nga të gjitha pretendimet, detyrimet dhe shpenzimet e lidhura me shërbimet e Deloitte, sipas kësaj marrëveshjeje, të cilat mund të shkaktohen nga mungesa e përfaqësimeve nga ana e Ministrisë së Financave, ose përdorimi i raportit të gjetjeve në kundërshtim me kushtet e rëna dakord në këtë marrëveshje.

7.5 Ministria e Financave duhet të bashkëpunojë plotësisht me Kontraktuesin dhe t'i vërë atij në dispozicion në afatin dhe formën e kërkuar çdo regjistrim kontabël, dokument, kontratë, korrespondencë apo informacion që kërkohet nga Kontraktuesi në lidhje me procesin e kryerjes së procedurave. Gjithashtu, Autoriteti Kontraktor do të bashkëpunojë me Deloitte në lidhje me kryerjen e shërbimeve, përfshirë këtu dhe lehtësimin dhe dhënien e aksesit në informacione, sisteme, zyra dhe personelin e qeverisë ose personave të tjerë, që kanë aftësi dhe eksperiencë dhe bashkëpunimi i të cilëve është i nevojshëm për kryerjen e shërbimit. Angazhimi i Deloitte do të bazohet në fakte dhe rrethana, saktësinë dhe vlefshmërinë e të gjitha informacioneve të grumbulluara e të dhëna nga Ministria e Financave apo ministri të tjera, për rrjedhojë Deloitte nuk është përgjegjës për ndonjë konkluzion të pasaktë, nëse kjo bazohet në një informacion të dhënë gabim apo informacion dhe/ose dokumentacion të kufizuar të dhënë nga qeveria gjatë kryerjes së angazhimit.

7.6 Ministria e Financave duhet të grumbullojë në formatin e kërkuar elektronik informacionet e dhëna nga kompanitë kontraktore mbi obligimet përkatëse përmes faqes së internetit të Ministrisë së Financave.

7.7 Ministria e Financave duhet të rishikojë dhe të japë komente mbi draftraportin e gjetjeve faktike brenda 5 ditëve kalendarike nga dorëzimi i draftraportit nga Deloitte.

Neni 8

Përgjegjësia dhe detyrimet e Kontraktuesit

8.1 Kontraktuesi do të realizojë kryerjen e plotë të shërbimit, objekt i marrëveshjes, siç specifikohet në nenin 2 më lart dhe në shtojcën A.

8.2 Kontraktuesi duhet të kryejë shërbimin në respekt të standardeve e praktikave më të mira ndërkombëtare dhe Kodit të Etikës për profesionin e auditorit.

8.3 Kontraktuesi duhet të ruajë paanshmërinë dhe pavarësinë gjatë gjithë periudhës së realizimit të marrëveshjes.

8.4 Kontraktuesi do të përgatisë raportin draft dhe atë përfundimtar të gjetjeve faktike në gjuhën angleze.

8.5 Brenda 7 ditëve kalendarike nga firmosja e marrëveshjes, Kontraktuesi do t'i japë Ministrisë së Financave listën me afate për dorëzimin e informacionit nga ana e Ministrisë së Financave dhe ministrive të tjera.

Neni 9

Kushtet e pagesës

9.1 Bazuar në një përllogaritje të kohës gjatë së cilës do të kryhet puna, tarifa do të faturohet dhe do të jetë e pagueshme si më poshtë:

Me firmosjen e marrëveshjes, 40% e vlerës së marrëveshjes;

Me dorëzimin e draftraportit, 50% e vlerës së marrëveshjes;

Me dorëzimin e raportit final, 10% e vlerës së marrëveshjes.

Faturat do të dërgohen në bazë të skedulit të mësipërm dhe pagesa duhet të kryhet brenda 7 ditëve nga data e faturimit. Deloitte ka të drejtën të ndërpresë shërbimet, objekt të kësaj marrëveshjeje, në rast të vonesës së pagesave të faturave të lëshuara.

Neni 10
Likuidimi për dorëzimin e vonuar

10.1 Dëmet e likuiduara për dorëzimin e vonuar do të llogariten me tarifën e mëposhtme ditore:
- Tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i marrëveshjes. Kjo vlerë do të llogaritet maksimalisht deri në 20% të vlerës së marrëveshjes.

10.2 Pagimi i penalitetit nuk e çliron Kontraktuesin nga detyrimet kontraktuale.

10.3 Penaliteti do të mbahet nga pagesa, sipas nenit 9 të kësaj marrëveshjeje.

Neni 11
Vonesat në kryerjen e pagesës

Afati i pagesës është 7 ditë nga data e faturës. Në rast se Autoriteti Kontraktues vonon pagesën e faturës, Deloitte ka të drejtë të marrë interes ditor prej 4/1000 e vlerës të mbetur pa paguar, për pagesën e vonuar.

Neni 12
Negociatat dhe amendamentet

Asnjë amendament ose variacion tjetër i marrëveshjes nuk do të jetë i vlefshëm pa qenë me shkrim, me datë, t'i referohet shprehimisht marrëveshjes dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i Kontraktuesit dhe Autoriteti Kontraktor.

Neni 13
Baza ligjore

Marrëveshja do të qeveriset dhe interpretohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

Neni 14
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

14.1 Të gjitha konfliktet që mund të lindin gjatë zbatimit të marrëveshjes, të dyja palët do të mundohen t'i zgjidhin me mirëkuptim, me negocim direkt.

14.2 Në rast të kundërt ato do të zgjidhen duke iu referuar gjykimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 15
Konfidencialiteti

Deloitte është dakord që çdo informacion i dhënë dhe dokument i lidhur me zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të trajtohet si konfidencial dhe nuk do t'u jepet palëve të treta pa miratimin e shoqërisë.

Fletët e punës të përgatitura në lidhje me shërbimet e Deloitte janë pronë e Deloitte, përbëjnë informacion konfidencial dhe do të mbahen nga Deloitte në përputhje me politikat e brendshme edhe me standardet profesionale.

Palët marrin parasysh dhe pranojnë që secila palë ka të drejtë të japë informacion konfidencial, kur janë të kërkuara nga ligji ose në përputhje me vendimet e gjykatave, njësive qeveritare, rregullatore apo autoritete të tjera rregullatore relevante. Dhënia e këtij informacioni nuk do të konsiderohet si shkelje e detyrimeve për konfidencialitet nga pala dhënëse. Në rast se nuk ndalohet nga legjislacioni përkatës, pala që jep informacionin do të bëjë çdo përpjekje të arsyeshme të njoftojë palën tjetër paraprakisht për nxjerrjen e informacionit dhe do t'i ofrojë palës tjetër asistencë në masë të arsyeshme, në mënyrë që pala tjetër të ndërhyjë dhe të ndalojë dhënien e informacionit, nëse kjo gjë është e përshtatshme. Në pamundësi

të njoftimit paraprak, pala dhënëse e informacionit, në rast se nuk është e ndaluar nga legjislacioni në fuqi, do të njoftojë palën tjetër për informacionin e dhënë menjëherë pas dhënies së informacionit.

Autoriteti Kontraktor lejon Deloitte që të përdorë si referencë shërbimet e kryera sipas kësaj marrëveshjeje, në propozime/oferta që do të bëhen në të ardhmen, letra reference dhe dokumente të ngjashme dhe në të njëjtën kohë, të përdorë emrin e tij, logon dhe të përshkruajë projektin në përgjithësi.

Neni 16
Përgjegjësia

Nëse ndonjëra nga palët nuk përmbush detyrimet sipas marrëveshjes, atëherë marrëveshja deklarohet e pavlefshme dhe pala fajtore është e detyruar të paguajë palën tjetër sipas kërkesave të ligjit shqiptar.

Shuma maksimale e detyrimit të Deloitte (duke përfshirë ortakët, drejtuesit dhe punonjësit) për çdo veprim, humbje, dëmtim, pretendim, detyrim, kosto ose shpenzim, që rrjedh nga kjo marrëveshje ose është e lidhur me këtë marrëveshje, nuk do të jetë më e madhe sesa shuma e paguar për shërbimet e ofruara.

Palët pranojnë dhe bien dakord që pala kontraktuese Deloitte, i referohet Deloitte Albania sh.p.k. një kompani anëtare e Deloitte Touche Tohmatsu Limited, një kompani britanike e kufizuar nga garancitë. Palët janë në dijeni se Deloitte Touche Tohmatsu Limited dhe as firmat e saj anëtare nuk kanë detyrime apo akte të tjera detyruese kundrejt njëra-tjetrës.

“Deloitte” i referohet një ose më shumë firmave të Deloitte Touche Tohmatsu Limited, një kompani private britanike e kufizuar nga garancitë dhe firmave të saj anëtare dhe filialeve dhe degëve të tyre përkatëse. As Deloitte Touche Tohmatsu Limited, as firmat e saj anëtare nuk kanë detyrime apo akte të tjera detyruese kundrejt njëra-tjetrës. Secila nga firmat anëtare është një entitet ligjor i ndarë dhe i pavarur, që ushtrojnë aktivitetet e tyre nën emrat “Deloitte”, “Deloitte&Touche”, “Deloitte Touche Tohmatsu” ose emra të tjerë. “Deloitte Central Europe” i referohet organizatës së firmave rajonale, firmave anëtare të Evropës Qendrore të Deloitte Touche Tohmatsu, të cilat janë nën çadrën e Deloitte Central Europe Holdings Limited. Shërbimet ofrohen nga degët dhe filialet e Deloitte Central Europe Holdings Limited, të cilat janë entitete të ndara dhe të pavarura. Deloitte Albania sh.p.k. është filial i Deloitte Central Europe Holdings Limited.

SHTOJCA A
PROCEDURAT

Kontraktori do të kryejë procedurat më poshtë dhe të raportojë gjetjet faktike.

A. Mbledhja e informacionit përmes tabelave të shpërndara te ministritë në lidhje me listën e obligimeve ndaj kompanive për punë të kryera, shërbime e mallra të blera deri në datën 31 gusht 2013.

B. Përmbledhje dhe analizë e të dhënave të grumbulluara nga ministritë, si më sipër dhe listimi i 150 obligimeve më të mëdha deri në datën 31 gusht 2013.

C. Dërgimi i letrave për konfirmim për balancave të obligimeve te kompanitë kontraktore deri në datën 31 gusht 2013, sipas informacionit të kontaktit të dhënë nga ministritë për 150 obligimet më të mëdha. Përmbledhja e përgjigjeve dhe analiza e diferencave mes shumave të dërguara nga kompanitë kontraktore dhe shumave të dhëna nga ministritë sipas procedurës në pikën A më lart.

D. Kërkesë informacioni te ministritë përkatëse në lidhje me diferencat e identifikuara mes shumave të dhëna nga ministritë dhe shumat e dhëna nga kompanitë kontraktore.

E. Përmbledhje dhe paraqitje e termave të pagesës së kontratave që lidhen me 50 obligimet më të mëdha deri në datën 31 gusht 2013, sipas listës së marrë nga ministritë, sipas procedurës në pikën A.

F. Kërkesë informacioni nga Thesari i Shtetit për pagesat e bëra në lidhje me kontratat që lidhen me 50 obligimet më të mëdha dhe krahasim me termat e pagesës.

G. Përmbledhje e informacionit të grumbulluar nga Ministria e Financave përmes faqes së saj të internetit të dorëzuar direkt nga kompanitë, të cilave ministritë u kanë obligime përmes plotësimit të

formës së vendosur *online* në faqen e ministrisë dhe dorëzimit të saj *online*. Krahasimi i këtij informacioni, nëse është në cilësinë e duhur, me informacionin e grumbulluar e analizuar më sipër për totalin e obligimeve dhe për 150 obligimet më të mëdha.

Deloitte nuk do të ndërmarrë procedura të tjera për të hulumtuar apo verifikuar saktësinë dhe plotësinë e informacionit të dhënë nga Ministria e Financave, ministritë e tjera apo palë të treta, jashtë procedurave të listuara më sipër.

Procedurat që do të kryhen nuk do të përbëjnë një auditim ose rishikim të kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit apo Standardet Ndërkombëtare për Angazhimet e Rishikimit dhe, si pasojë, Kontraktori nuk do të japë siguri mbi informacionin financiar.

SHTOJCA B
KUFIZIMI I PËRGJEGJËSISË, SHKARKIMI DHE ZHDËMTIMET

a) Ministria e Financave bie dakord që Deloitte dhe personeli i saj nuk do t'i detyrohen ministrive për asnjë pretendim, detyrim apo shpenzim në lidhje me këtë angazhim, që tejkalon shumën e paguar ndaj Deloitte sipas kësaj marrëveshjeje. Në asnjë rast, Deloitte apo personeli i saj nuk do të jenë përgjegjës për humbje, dëme ose shpenzime të rëndësishme, indirekte, aksidentale, të rastësishme apo ndëshkuese të lidhura me këtë angazhim.

b) Ministria e Financave bie dakord që të çlirojë apo të zhdëmtojë Deloitte dhe personelin e saj prej çdo pretendimi, detyrimi apo shpenzimi në lidhje me këtë angazhim që mund të shkaktohen nga mungesa e përfaqësimeve nga ana e drejtuesve të Ministrisë së Financave.

c) Autoriteti Kontraktor bie dakord që të ruajë të parrezikuar dhe të zhdëmtojë Deloitte dhe personelin e saj nga çdo pretendim, detyrim dhe shpenzime në lidhje me këtë angazhim, që lindin si rrjedhojë e shkeljeve apo dyshimeve për shkelje të kushteve të kësaj letre angazhimi, duke përfshirë, pa përjashtim, edhe kufizimin në përdorim dhe shpërndarjen e raportit.

d) Dispozitat e paragrafit 1 do të aplikohen në shtrirje të plotë të ligjit, qoftë për kontratën, statutin, dëmet (si neglizhenca) apo tjetër. Në rrethanat kur të gjitha apo një pjesë e kushteve të paragrafit 1 janë gjykuar përfundimisht si jo të vlefshme, detyrimi i Deloitte për çdo pretendim, detyrim apo shpenzim në lidhje me këtë marrëveshje nuk do të tejkalojë një shumë në përpjesëtim me fajin përkatës që aktet e Deloitte kanë mbi çështjen që solli ngritjen e këtyre pretendimeve, detyrimeve apo shpenzimeve.

2. Vijimësia dhe interpretimet

Për qëllime të dispozitave të paraqitura në seksionin "Pranime dhe marrëveshje" të kësaj letre angazhimi, "Deloitte" i referohet Deloitte Albania sh.p.k. një kompani anëtare e Deloitte Touche Tohmastsu Limited, një kompani britanike e kufizuar nga garancitë. Qeveria është në dijeni se as Deloitte Touche Tohmatsu Limited dhe as firmat e saj anëtare nuk kanë detyrime apo akte të tjera detyruese kundrejt njëra-tjetrës. Qeveria pranon që çdo firmë tjetër anëtare e Deloitte Touche Tohmatsu Limited është një kompani e pavarur ligjore dhe, rrjedhimisht Qeveria nuk ka asnjë të drejtë rivendosjeje në kushtet e kësaj marrëveshjeje ose të kontraktojë kundër ndonjë firme tjetër anëtare ose vartëset e tyre, ose anëtare të Deloitte Touche Tohmatsu Limited apo kundër Deloitte Touche Tohmatsu Limited.

SHTOJCA C
PRANIME DHE MARRËVESHJE

- Procedurat për të cilat është rënë dakord që Deloitte të kryejë, me kërkesë të Ministrisë së Financave dhe me miratimin e Deloitte, janë të kufizuara në natyrë dhe nuk përfshijnë të gjitha çështjet në lidhje me procedurat që mund të lidhen me, ose që janë të nevojshme për përcaktimin e madhësisë së obligimeve të ministrive ndaj kompanive deri në datën 31 gusht 2013, për shërbime të kryera apo punime të bëra. Për rrjedhojë, procedurat nuk do të kryhen për të zëvendësuar hetime dhe procedura që Ministritë duhet të ndërmarrin për qëllimin e përshkruar më sipër.

- Raporti i Deloitte nuk do të shtrihet mbi pasqyrat financiare të ministrive apo Ministrisë së Financave në tërësi, apo mbi kontrollin e saj të brendshëm për ndonjë datë apo periudhë.

- Natyra, qëllimi dhe hartimi i procedurave të paracaktuara, të cilat kërkohen që të kryhen nga

Deloitte, janë ekskluzivisht përgjegjësi e Ministrisë së Financave. Veç kësaj, Deloitte nuk ka përgjegjësi për të këshilluar ministritë për procedura të tjera që mund të kryhen dhe nuk bën përfaqësime, për qëllime të qeverisë, lidhur me mjaftueshmërinë e këtyre procedurave.

- Përgjegjësia e Deloitte është e kufizuar në kryerjen e procedurave specifike dhe të paracaktuara dhe raportimin e gjetjeve faktike, subjekt i kufizimeve që përcaktohen më poshtë, dhe ky angazhim i Deloitte nuk mund të merret për bazë për zbulimin e mangësive të rëndësishme, gabimeve apo mashtrimeve, në rast se këto ekzistojnë. Deloitte nuk ka përgjegjësi për përditësimin e procedurave të kryera, apo për kryerjen e procedurave shtesë.

- Qeveria do të jetë e vetmja përgjegjëse për paraqitjen e informacionit financiar dhe informacioneve të tjera, si dhe për pajtueshmërinë e tyre me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

- Qeveria do të jetë përgjegjëse për sigurimin e informacionit të plotë dhe të saktë të kërkuar nga Deloitte. Deloitte nuk ka përgjegjësi për plotësinë dhe saktësinë e informacionit të siguruar nga, ose në emër të Qeverisë, edhe nëse Deloitte kishte arsye të ishte në dijeni, ose duhej të ishte në dijeni të këtyre pasaktësive dhe mangësive.

- Përpara përfundimit të këtij angazhimi, Deloitte mund t’i kërkojë Qeverisë t’i sigurojë letrën e përfaqësimit, ku Qeveria pranon përgjegjësi për përgatitjen dhe paraqitjen e informacionit financiar të nevojshëm për kryerjen e procedurave dhe konfirmon disa përfaqësime të bëra ndaj Deloitte gjatë angazhimit.

- Çdo raport i lëshuar nga Deloitte nuk do të përdoret ose qarkullohet, citohet, paraqitet apo shpërndahet, e as nuk do t’i referohet këtij raporti apo angazhimit të Deloitte, palëve të tjera, përveç anëtarëve të Këshillit të Ministrave apo stafit drejtues të Ministrisë së Financave.